



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-054

Prishtinë, më 12 mars 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË TË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 12 MARS 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Millosavleviq dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi, Ismet Hajrullahu dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga Zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Në fillim të mbledhjes, kryetari kërkoi nga shefat e grupeve parlamentare dhe administrata e Kuvendit që kërkesat për udhëtime zyrtare, të mos procedohen në Kryesinë e Kuvendit, pa pasur ftesë zyrtare nga trupat e parlamenteve homologe, si dhe duhet të procedohen përmes Zyrës për bashkëpunim me jashtë. Me këtë duhen të njoftohen të gjithë deputetët e Kuvendit.

Në vazhdim, Kryesia i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 5 mars 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës, më 15 mars 2012,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 5 mars 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 5 mars 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës, 15 mars 2012

Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja plenare e radhës të mbahet të enjten, më 15 mars 2012, me këtë

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për komunikimet elektronike,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për deminimin humanitar,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për pensionet e pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimet e shoqërisë informatike,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 04/L-46 për transmetimin publik në Kosovë,
9. Shqyrtimi i Raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Ftesë e Komisionit për Punë të Jashtme të Parlamentit të Republikës së Hungarisë, për ta vizituar Kuvendin e Republikës së Kosovës

Kryesia, pasi shqyrtoi ftesën e cekur më lart, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Komisionit për Punë të Jashtme, për të ftuar Komisionin homolog për Punë të Jashtme të Parlamenti të Hungarisë, për vizitë zyrtare në Kosovë, gjatë muajit maj 2012.
2. Shpenzimet e akomodimit dhe ushqimit për delegacionin e Punëve të Jashtme të Parlamentit të Hungarisë, gjatë kësaj vizite zyrtare në Kosovë, do të mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:15** minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale